



Thames View Infants

Prospekti i Akademisë

Ju urojmë mirëseardhjen nga ana e personelit dhe drejtuesve të akademisë tonë multikulturore që ka fituar shumë çmime.

Unë besoj se fëmijët kanë vetëm një shans për të dalë me sukses në shkollë dhe të gjitha energjitë e mia në 8 vitet e fundit si drejtor i shkollës në TVI janë dedikuar për ta bërë këtë gjë mirë: duke i dhënë fëmijëve tuaj – dhe familjeve të tyre – fillimin më të mbarë në jetë dhe arsimin më të mirë për të vegjlit.

Ne kemi qenë shumë të suksesshëm në këtë gjë: Arritja në Thames View Infants është tek 20% e të gjithë shkollave në rang kombëtar dhe për disa vjet tashmë, ne jemi renditur si shkolla për të vegjlit me arritjet më të mira në Barking dhe Dagenham, duke ia kaluar shkollave kryesore në të gjithë Londrën. Ministria e Arsimit na ka caktuar zyrtarisht edhe si një Shkollë Drejtuese në Arsim dhe Mbështetje të Specializuar.

Ne jemi gjykuar nga Ofsted si shkollë e “Shkëlqyer” dy herë (në 2009 dhe sërish në 2014). Ne besojmë se do vazhdojmë ta ruajmë këtë standard.


Personeli im dhe unë jemi të dedikuar që t’i bëjmë gjërat mirë për ju dhe familjen tuaj. Të jeni të sigurt se ne do të bëjmë ç’është e mundur që t’i japim fëmijës tuaj përvojën më të mirë të mundshme në mësim dhe t’ju ofrojmë ju një shërbim të shkëlqyer ndaj klientit dhe mbështetje familjare.

Këtu më poshtë është një përmbledhje e informacioneve të rëndësishme dhe të dobishme për juve.

Së bashku me mbështetjen tuaj të vyer dhe kujdesin prindëror, fëmija juaj do të mbarojë shkollën i përgatitur jashtëzakonisht mirë për fazën tjetër në edukimin e tyre: qytetarë britanikë të shkëlqyer, të fuqizuar, me vetëbesim, drejtues të së ardhmes, të mëshirshëm, të përgatitur dhe të arsyeshëm, të përgatitur në lexim e matematikë.

Paul Jordan
Drejtori

Misioni ynë



Në Thames View Infants, ne punojmë shumë që të ofrojmë një komunitet shkollor argëtues e perkkrahës, i cili kujdeset për fëmijët, ku në qendër të vëmendjes vendoset secili fëmijë së bashku me familjen e tij.

Ne ofrojmë një mjedis mësimdhënieje ku kushdo arrin potencialin e tij të plotë, pavarësisht nga origjina ku fillojnë.



Ne u mësojmë fëmijëve t’i respektojnë, t’i pranojnë e t’i vlerësojnë shokët e tyre të klasës dhe të rriturit si në komunitetin tonë shkollor multikulturor ashtu edhe në jetën e tyre jashtë shkollës, duke u bërë shembull për të tjerët.

Ne dëshirojmë që fëmijët të kënaqen gjatë kohës, që janë në shkollë dhe kemi krijuar një mjedis të sigurt e të rehatshëm, në të cilin ata ndiejnë kujdesin dhe vlerësimin, duke zhvilluar kështu te fëmijët pavarësinë, vetëbesimin dhe aftësinë për të marrë vendime për vetveten.

MR. HAPPY
By Roger Hargreaves



Ne synojmë që komunitetin tonë shkollor ta kthejmë në një mjedis mikpritës dhe miqësor dhe besojmë se është e rëndësishme që prindërit dhe mësuesit të punojnë krah për krah njëri-tjetrit, për të ndihmuar dhe mbështetur fëmijët.

Për shkak se ne duam që t'i ndihmojmë familjet tona të përfitojnë sa më shumë nga koha e tyre me ne, ne organizojmë edhe një numër shërbimesh që zgjerojnë atë që ofron shkolla dhe dita e shkollës.



Po ashtu ne punojmë ngushtë me profesionistë partnerë kryesorë brenda zonës tonë dhe jemi krenarë për lidhjet tona të mira. Këto përfshijnë shkollën Thames View Junior, Qendrën e Fëmijëve Sue Bramley, çerdhen Chestnuts, qendrën shëndetësore Thames View, çerdhen Christchurch, shërbimet sociale, shkollat përreth dhe shërbimet mbështetëse dhe arsimore brenda bashkisë londineze Barking dhe Dagenham



Së bashku ne ofrojmë një rrjet shumë të efektshëm për familjet dhe një ofrim gjithëpërfshirës.



Oraret e shkollës



Çerdhja	3-4 vjeç	08:45 deri 11:45 dhe 12:30 deri 15:30
Receptions	4-5 vjeç	08:55 deri 11:45 dhe 13:00 deri 15:15
Klasa 1-rë & Klasa 2-të	5-6 vjeç	08:55 deri 12:45 dhe 13:15 deri 15:15

Ju lutemi përpquni që fëmija juaj të vijë në orar. Çdo klasë e fillon ditën me aktivitete leximi ose numërimi dhe fëmija juaj mund të humbasë mësim të rëndësishme, nëse vjen me vonësë.



Përpquni që të mbërrini rreth 5 minuta përpara fillimit të shkollës në mënyrë që të mos prisni gjatë, sidomos gjatë ditëve të ftohta e me shi.



Ne kemi një Klub Mëngjesi për prindërit që punojnë të fëmijëve të KS1, i cili fillon nga ora 08:00 dhe pranimit i fundit është në orën 08.20. Gjatë kësaj kohe, për fëmijët kujdeset personeli i shkollës. Kjo kryhet kundrejt një tarife të vogël. Një fillim herët nuk është i përshtatshëm për të gjithë fëmijët dhe nëse doni që fëmija të ndjekë Klubin e Mëngjesit, ju lutemi e jani dhe flisni me Claire Smith, Zëvendës-drejtoresha ime.





Nëse jeni me vonesë, ju lutemi të mos e mbani fëmijën në shtëpi gjatë gjithë ditës – ne do të preferonim më shumë, që fëmija të vinte me vonesë, sesa të mos vinte fare. Kur të mbërrini në shkollë, duhet të takoni personelin e zyrës për t’u siguruar që të regjistrohet vijimi i fëmijës suaj si dhe që të porositet dreka.

Iniciativat e shkollës

Si një shkollë ‘e zgjeruar’, ne u sigurojmë fëmijëve një shumëllojshmëri klubesh me aktivitete gjatë mbrëmjeve, të cilat fëmijët i frekuentojnë falas. Këto përfshijnë stërvitjen e futbollit, kërcimin dhe kompjuterin. Përsëri, një ditë e gjatë nuk është e përshtatshme për të gjithë fëmijët, por ne përpiqemi t’i favorizojmë dëshirat e të gjithëve, kur përshtatim klubet me preferencat.



Ne kemi edhe një Këshillues për Përkrahjen e Prindërve, i cili organizon një shumëllojshmëri grupesh për ta dhe mund të ofrojë ndihmë për shumë nga problemet e përditshme me të cilat përballen familjet. Ejani dhe ndani me të tjerët të gjitha shqetësimet që mund të keni, përpara se ato të bëhen shumë të mëdha.



Të gjithë fëmijët në klasën e 2-të mund të huazojnë një Ipad ose të marrin pjesë në Skemën tonë vullnetare të blerjeve. Ne jemi një shkollë që ka shumë mjete të teknologjisë së informacionit dhe kemi fituar një numër çmimesh kombëtare për këto ofertë të gjerë. Fëmijët gjatë gjithë kohës në shkollë përdorin rregullisht laptope, iPads, Androids, Wiis/Xboxes si dhe teknologji më tradicionale.



Përgjegjësi ynë teknik do t’i përgjigjet çdo pyetjeje, që mund të keni për kompjuterin tuaj të shtëpisë. Ejani dhe flisni me të dhe ai do të bëjë maksimumin, që t’ju japë ndihmë praktike.

Ne e vlerësojmë “Prindërit si partnerë” dhe komunikimi i mirë ndërmjet shtëpisë dhe shkollës është thelbësor. Ka shumë mënyra për t’u mbajtur në kontakt me ne ose për të mësuar se çfarë po ndodh prapa skenave:

Gjëja e parë që duhet të bëni është të shkarkoni aplikacionin tonë. Ai ju ndihmon të:

- ✓ **na jepni mendimet tuaja**
- ✓ **të lexoni blogun tonë**
- ✓ **të kontrollni datat dhe ngjarjet**
- ✓ **të vizitoni faqen e internetit të shkollës**
- ✓ **të na kontaktoni jashtë orarit**
- ✓ **abonohuni te buletini ynë informativ** (dhe mos humbisni kurrë një buletin të rëndësishëm përsëri!)



Personelil im dhe unë publikojmë tweets çdo ditë: është mënyra më e shpejtë dhe më e mirë për të mësuar se çfarë ndodh rreth shkollës. Abonohuni në twitter-at tanë dhe mësoni shumë gjëra.

follow us on
twitter

@TVInfants (Paul Jordan, Drejtori)

@ClaireTVI (Claire Smith, Z/drejtoresha)

@Khaled_a_Ali (Khaled Ali, Shefi i EYFS)

@TVI_MissCJones (Rosa Corcoran-Jones, Ndhmës Drejtoresha)

@FiBashirTVI (Fi Bashir, Profesionisti për Fëmijët dhe Familjen)

@TVI ICTSupport (Simon Mordecai, Menaxheri i Teknologjisë së Komunikimit dhe Informatikës)



Shikoni kanalin tonë në "YouTube" Channel... [Thames View Infants TV \(TVI TV\)](#).

Përmban 250 video të podcasteve të mësuesve dhe këshillat tona më të mira për të mësuar!

Është gjithmonë shumë mirë për tu takuar 'ballë për ballë' me mësuesit, sidomos kur bëhet fjalë për mësimet. Megjithatë, ne e kuptojmë që jeta e prindërve mund të jetë shumë e ngarkuar dhe ndonjëherë është e vështirë të gjendet koha për të folur. Nëse ju, ose fëmija juaj, keni ndonjë pyetje në lidhje me detyrat e shtëpisë apo keni nevojë për këshilla mbi leximin në shtëpi, mund të na dërgoni një e-mail në adresën elektronike:

HomeworkHelp.TVI@bdcs.org.uk

Mësuesit tanë do të përpiqen t'i përgjigjen pyetjes suaj, ose mund të lënë me ju një takim për t'ju ndihmuar më tej në një orar të përshtatshëm.

**LITTLE MISS
WONDER**

by Seven Hundred



Uniforma e shkollës është e detyrueshme në Akademinë tonë. Veshja e uniformës ndihmon për të krijuar një ndjenjë përkatësie në shkollë dhe krijon idenë e një ambjenti të mirë pune. Fëmijët në shkollë veshin një bluzë me mëngë të shkurtra, që mund të blihet nga zyra e shkollës në një nga gjashtë ngjyrat e ndezura – e bardhë, e gjelbër, e verdhë, e purpurt, rozë e ndezur dhe bojëqelli. **Fëmijët mund të veshin çdo ngjyrë në çdo ditë, por duhet të veshin bluzën e shkollës.** Na vjen keq, por fëmijët nuk lejohen të mbajnë bizhuteri në shkollë.



Nuk është e shëndetshme që fëmijët të vijnë në shkollë të veshur trashë në mot të ngrohtë. Fëmijët janë shumë aktivë në shkollë dhe nëse veshin shtresa të panevojshme (kanatiere, streçe, bluza dhe triko) kjo mund të bëjë që fëmijët të nxehen shumë. Po ashtu rritet mundësia që të humbasin sendet kur fëmijët i heqin gjërat e tepërta, për t'u freskuar. Ju lutemi visheni fëmijën tuaj në mënyrë të përshtatshme me motin. Në kthim, ne do t'i ndihmojmë ata që të jenë të shëndetshëm (përfshi inkurajimin e tyre që t'i zhveshin dhe veshin vetë rrobat kur është ose shumë ngrohtë ose shumë ftohtë).

Vijimi në shkollë

Ligji kërkon që fëmijët ta vijnë shkollën rregullisht dhe që për arritjen e kësaj të angazhohen prindërit ose kujdestarët e tyre. Çdo mungesë është e papranueshme përveç rasteve të sëmundjes.



Të gjitha pushimet familjare duhen bërë gjatë pushimeve të publikuara shkollë.



Shkolla nuk do të japë leje për asnjë pushim familjar gjatë semestrave shkollorë. Prindërit që marrin pushim të paautorizuar ose e kalojnë datën e rënë dakord për kthimin do të rrezikojnë:

- **Një gjobë fikse për (për të rriturit) DHE për fëmijën (edhe nëse fëmijët e tjerë ndjekin një shkollë tjetër).**
- **Humbjen e vendit të shkollës për fëmijën.**
- **Ri-regjistrimin me Autoritetin Vendor për një vend të ri shkollë.**
- **Të dhënat e familjes do t'i jepen Punonjësit të Vijimit në shkollë në Bashki.**

Por nëse fëmija juaj nuk dëshiron të vijë në shkollë, ejani dhe flisni me ne. Ndoshta mund të ketë një arsye për këtë dhe ne do të bashkëpunojmë për të ndihmuar në zgjidhjen e problemit.



Vijimi rregullisht i shkollës dhe ardhja në orar janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen e fëmijës në shkollë.



Çfarë duhet të bëj nëse fëmija im është i sëmurë?

Nëse fëmija juaj është vërtet shumë sëmurë, atëherë duhet të qëndrojnë në shtat në shtëpi derisa të shërohet.



Në rast të tillë, ju lutemi telefonojni (**020 8270 4317**) ose dërgojni një mesazh SMS (**07943 922 655**) zyrës së shkollës sonë rreth orës 10:00 për çdo ditë që fëmija juaj mungon dhe na informoni se si është me shëndet. Ne ndjekim këshillat e qeverisë për problemet me shëndetin dhe do t'ju ofrojmë edhe juve këshilla.

Ne ofrojmë një ambient të kujdesshëm e ndihmues dhe mund të ndihmojmë që fëmija juaj të kthehet në shkollë më shpejt duke përdorur mënyra të ndryshme:

- Duke i dhënë ilaçet fëmijës suaj (nëse plotësoni një formular të veçantë në zyrë)
- Duke u kujdesur pak më shumë për fëmijën tuaj gjatë kohës që shërohet dhe duke ju informuar mbi mbarëvajtjen e tij shëndetësore.
- Duke folur me mjekët e përgjithshëm në Qendrën Mjekësore Thames View që ndodhet pranë nesh.
- Duke u ofruar atyre zgjedhje të veçanta në ushqime për vaktin e drekës (nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë).
- Duke punuar me ju dhe fëmijën tuaj nëse nuk është sistemuar mirë ose nëse keni probleme që ta sillni fëmijën në shkollë çdo mëngjes.
- Duke i ndihmuar fëmijët të arrijnë orët ku kanë munguar.



Cili është "vijimi i rregullt"?

Duke qenë se mund të jetë shumë e dëmshme për arsimimin e fëmijëve, nëse nuk e vijnë shkollën rregullisht, **Qeveria ka vendosur për të gjitha shkollat Synimin Kombëtar për Vijimin e Shkollës, i cili synon që nxënësi të vijojë 95% të totalit të orëve.**




Kjo do të thotë që, gjatë vitit shkollor, fëmijët mund të mungojnë *mesatarisht* vetëm 1 ditë shkolle në muaj (ose gjysmë dite gjatë një periudhe dy-javore). Ne jemi me shumë fat, sepse fëmijët mungojnë shumë rrallë në shkollën tonë.

Tashmë në shkollën Thames View Infants shumë fëmijë e vijnë shkollën çdo ditë dhe kanë një vijim prej 100%.



Çdo semestër ne vlerësojmë me çmime të gjitha familjet tona, që arrijnë 100% Vijim në shkollë në një "Asamble Lulesh" të veçantë dhe shumë popullore.



Gjithashtu, ne i dhurojmë një biçikletë një fëmije që ka treguar një përmirësim të dukshëm të vijimit në shkollë gjatë vitit deri tani.



Si mund ta di vijimin e fëmijës tim në shkollë?

Ne bashkëpunojmë me familjet tona dhe si shkollë e monitorojmë vazhdimisht vijimin e nxënësve. Ne flasim me ju që në momentin që vërejmë rënien e vijimit në shkollë nga fëmija juaj.

Vazhdimisht, çdo dy javë, ne kontrollojmë zyrtarisht vijimin e shkollës për të gjithë fëmijët. Çdo semestër ne i shkruajmë çdo prindi nëse vijimi nga ana e fëmijës së tij bie nën nivelet e mëposhtme:



- ✓ 100% (nuk munguan kurrë)
- ✓ 97% (rreth gjysmë dite mungesë në muaj)

- ✗ Nën 95% (gjysmë dite mungesë për periudhë dyjavore)
- ✗ Nën 90% (gjysmë ditë për periudhë javore)
- ✗ Nën 85% (pothuajse një ditë për periudhë javore)
- ✗ Nën 75% (pothuajse një ditë e gjysmë për periudhë javore)



Megjithëse një vijim prej 90% duket shumë i lartë, gjatë karrierës arsimore të një fëmije, 10 përqindëshi i munguar mund të rezultojë në humbjen e një viti të tërë akademik shkollor. Duke e sjellë këtë në vëmendjen tuaj nëpërmjet një letre, ne mund të bashkëpunojmë për të ndihmuar në përmirësimin e mbarëvajtjes së fëmijës suaj dhe suksesit të tij si nxënësi.



Cilat janë pasojat e vijimit të ulët?

(A+)

Vijimi jo i rregullt i shkollës mund të jetë shumë i dëmshëm për arsimimin e fëmijës. Nga ana statistikore, fëmijët me vijim më të lartë se 90% marrin nota më të mira në provime dhe kanë mundësi më të larta të gjejnë punë të mira më pas në jetë.

Fëmijët me vijim të ulët kanë probleme në përfshirjen në jetën shkollore dhe kanë tendencën të kenë vështirësi në krijimin e shoqërive.



Nëse mungojnë rregullisht, fëmijët e kanë gjithnjë e më të vështirë të arrijnë me punën për orët që kanë humbur.


Shpesh, fëmijët që nuk e vijnë shkollën rregullisht konsiderohen si më të dobët.



Trusti i kësaj Akademie punon ngushtë me autoritetet Lokale të Bashkisë së Londrës Barking & Dagenham, të cilët ndjekin penalisht familjet, të cilat nuk arrijnë të garantojnë vijimin e rregullt të fëmijëve të tyre në shkollë, sepse kjo është një shkelje ligjore. Prindërit/kujdestarët rrezikojnë të gjobiten, të dërgohen përpara gjykatës, të detyrohen të marrin pjesë në kurse për prindër ose në rastet më serioze edhe të burgosen.

Ne nuk dëshirojmë që kjo të ndodhë me asnjë nga familjet e nxënësve të Thames View Infants.

Shkolla jonë karakterizohet nga një atmosferë e dashur dhe e gëzuar, dhe ka një listë të gjatë pritjeje, prandaj kjo gjë nuk është e drejtë për familjet që dëshirojnë t'i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollën tonë dhe që nuk mundën për shkak të mungesës së vendeve të lira.



Procedurat e pranimit në shkollë

Për çdo klasë ne kemi një numër të caktuar vendesh.



Thames View Infants ndjek marrëveshjet e pranimit të rëna dakord me Bashkinë e Londrës Barking dhe Dagenham.

Nëse kërkesat për vende në shkollë nuk janë më shumë se numri i nxënësve që mund të pranojmë, atëherë Autoriteti Lokal është në gjendje të pranojë të gjithë fëmijët që kanë nevojë për vende në shkollë. Në rast se ka më shumë aplikantë sesa vende, atëherë Autoriteti Lokal përcakton kritere pranimi për të vendosur se cilët nxënës mund të fitojnë një vend në shkollë dhe cilët jo. Kriteret e pranimit janë si më poshtë:

1. Fëmijët që janë nën kujdesin e autoriteteve lokale.
2. Fëmijët që kanë një vëlla ose motër që vijon shkollën Thames View ose shkollën Thames View Junior.
3. Fëmijët që jetojnë më pranë shkollës, distancë kjo e matur sipas rrugës më të shkurtër në këmbë.



Emrat e fëmijëve që nuk u ofrohet një vend në shkollë vendosen në një listë pritjeje në pritje të një vendi të lirë.

Procedurat e ankesave

Ne përpiqemi të ofrojmë një arsim të mirë për të gjithë fëmijët tanë. Drejtori dhe personeli punojnë shumë për të ndërtuar një marrëdhënie pozitive me të gjithë prindërit. Megjithatë Thames View Infants, si Akademi, i kërkohet me ligj të ketë dhe t'iu publikojë prindërve procedurën e tyre të ankesave.

Herë pas here prindërit dhe kujdestarët kanë shqetësime normale dhe legjitime rreth ecurisë, arritjeve, sjelljes ose mirëqenies së fëmijëve të tyre ose rreth çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me shkollën. Shumica e keqkuptimeve shpesh janë të paqëllimshme dhe mësuesit tanë do t'ju dëgjojnë e do të veprojnë me maksimumin e mundësive të tyre për ta zgjidhur çështjen. Në shumicën e rasteve është gjithnjë më mirë që fillimisht çdo problem apo shqetësim ta ngrini menjëherë me mësuesin e fëmijës; megjithatë, në vartësi të natyrës së ankesës, mund të jetë e nevojshme që ju ta ngrini çështjen direkt me drejtorin – i cili, në vartësi të natyrës së incidentit, do ta adresojë çështjen ose zyrtarisht ose jo-zyrtarisht.

Ankesat adresohen nëpërmjet një procesi me 4 faza, që mund të shihet i plotë këtu:

<http://is.gd/19bK7f>



Rregullorja dhe Ruajtja e Kodit të Sjelljes.

Ne ndjekim një numër udhëzimesh për të zbatuar Udhëzimet Ligjore e siguruar që fëmijët tanë të jenë të sigurt dhe të mirëkujdesur. Nganjëherë, ne jemi të detyruar që ta ndajmë informacionin me Punonjësën e Caktuar të Autoriteteve Vendore (për Mbrojtjen e Fëmijëve) dhe të kërkojmë këshillat ose udhëzimet e tyre.

Ne po ashtu e kemi për detyrë dhe jemi përgjegjës që të sillemi në mënyrë të përshtatshme dhe profesionale në ambientet e shkollës. Duke e bërë këtë gjë, ne formojmë marrëdhënie harmonike pune, bazuar mbi të cilat fëmijët lulëzojnë dhe zhvillohen. Një kopje e Rregullores së Kodit të Sjelljes është afishuar në Zyrën e Shkollës tonë.

Shpresojmë që ky informacion të jetë i dobishëm për ju. Megjithatë, këtu tregohen vetëm disa nga gjërat që ne bëjmë në shkollë – prandaj ju lutemi që të vini dhe të na pyesni pranë Zyrës së Shkollës në lidhje me gjithçka tjetër, që dëshironi të dini, si janë mëngjeset e kafeve, si të merrni me email buletin tonë informativ... ose thjeshtë për të na përshëndetur!

Një numër i gjerë informacionesh dhe burimesh të mëtejshme gjenden në faqen e internetit të shkollës sonë:



TVIacademy.org